

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Si në kohën e Hitlerit"! Lavrov: Gjermania s'ka zënë mend nga lufta - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/si-ne-kohen-e-hitlerit-lavrov-gjermania-ska-zene-mend-nga-lufta/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 08:38:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 08:34:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3aa14431671b2db69a308f73b0b1ceacec30a30181f8cea00484940ce86e0396
TEKSTI	1132993ce64d14acf599b11599722bac058672913000c397490c5d1891379472
PAMJA	e53a3ff0fb93644e4ab334df3cd17fb565fd5ae3bc22a84ff151369cc5313a35

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d1f98104bf4ac9a1e62e1ffebbcf9c1fc52ebb6bd212953bffb1c0f23cd64ec3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b15fa4fb9899cfd04d55deb4808016b106f413d91b2f45c6fda6eeee1406fd0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/d1f98104bf4ac9a1e62e1ffebbcf9c1fc52ebb6bd212953bffb1c0f23cd64ec3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Shqipëri-Bjellorusi Donald Trump SHBA Sergey Lavrov Pakistan

EVROPA

“Si në kohën e Hitlerit”! Lavrov: Gjermania s’ka zënë mend nga lufta

27 Shtator 2026 | 10:34

Ministri i Jashtëm rus ka hedhur poshtë thirrjet e homologut gjerman që Moskë të tërhiqet nga “hapat e rrezikshëm përshkallëzues”, duke akuzuar Berlinin se është sponsori kryesor i Ukrainës.

Sergey Lavrov u takua me ministrin gjerman Johann Wadepul në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ditën e shtunë, pak përpara se të mbante fjalimin përpara liderëve botërorë.

Gjatë bisedimeve, ministri gjerman i bëri thirrje Rusisë që të heqë dorë nga “shtegu i rrezikshëm i përshkallëzimit” dhe shprehu gatishmërinë e Berlinit për të përmirësuar marrëdhëniet me Moskën, gjithmonë nëse Kremlini tregon vullnet për të përfunduar luftën ndaj Ukrainës.

Por Lavrov e dha përgjigjen e tij përpara audiencës. “Kancelari Merz thotë se Gjermania duhet të jetë sërish fuqia e parë ushtarake në Evropë. A e kupton Berlini se çfarë mund të sjellë kjo? Nuk kanë mësuar gjë gjermanët nga leksionet e Luftës së Dytë Botërore?”, u shpreh Lavrov.

Ndërsa në një konferencë shtypi të mbajtur pas fjalimit, kryediplomati rus u pyet mbi takimin e tij me homologun Wadepul dhe marrëdhëniet ruso-gjermane.

“Asgjë e re nuk erdhi nga nisma e ministrit të Jashtëm. Ai thjesht përsëriti qasjen e tij publike, duke dënuar Rusinë. Ju mund ta gjykonit vetë nëse kjo vlen për dialog apo jo”, tha Lavrov.

Tensionet mes Gjermanisë dhe Rusisë prekën fundin në fillim të shtatorit, kur Berlini akuzoi Moskën se fshihej pas sulmit me dron në aeroportin e Lajpcigut, në gusht.

Vetë Wadepul njoftoi atëherë masa të reja ndaj Rusisë, si mbylljen e konsullatës ruse në Bon dhe qendrën kulturore ruse në Berlin, e konsideruar si vatër spiunazhi.

Ai tha gjithashtu se autoritetet gjermane do të ushtrojnë kontrolle më të forta kufitare për shtetasit rusë dhe se do të rriste presionin ndaj flotës hije të Kremlinit.

LAJMI I FUNDIT

10:36 Në pritje të përgjigjes zyrtare, Irani reagon pas refuzimit të Trump

10:21 Nëntë të arrestuar në Zubin Potok për krime lufte, operacioni lidhet me rastin “Grupi i intelektualëve”

10:14 Rrëzohet helikopteri në Kanada, humbin jetën 4 persona

09:47 SHPËRNDARJE
ARTIKULLINDEKUR dhe 18 të plagosur nga një sulm ndaj një pike kontrolli

09:09 Shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, arrestohen 31 persona, 14 të tjerë në kërkim

09:06 Afrika e Jugut, të paktën 17 të vdekur dhe 15 të plagosur në sulm të armatosur në një bar

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | EVROPA

Vizita në Francë, 600 mijë njerëz presin meshën që do të mbajë Papa në Paris

Papa Leo XIV edhe këtë të shtunë po vijon vizitën e tij në Francë. Ai pritet të zhvillojë një Meshë të madhe në natyrë në...

14:49 | 26/09/2026

BOTA | EVROPA

Mijëra protestues dalin në rrugët e Madridit në protestë, shkak kriza e emigrantëve në Ceuta

Mijëra njerëz po marrin të shtunën pjesë në "Marshimin për Dinjitet" në Madrid, me protestuesit që bëjnë thirrje për zgjidhje e situatës me emigrantët në...

14:35 | 26/09/2026

BOTA | EVROPA

Shtatë të vdekur në Kiev nga sulmet ruse, Putin: Do të mendojmë me kujdes për bisedimet për paqe

Një sulm me dron në një ndërtesë zyrash në Kiev vrau shtatë persona, përfshirë një 14-vjeçar. I njëjti sulm plagosi 46 të tjerë, tha kryebashkiaku...

14:24 | 26/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: